

VENDIM
Nr.58, datë 5.12.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Ha1il Kopani,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto, më datë 25.11.1997 mori në shqyrtim kryesisht çështjen nr.59 Akti që u përket:

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, i përfaqësuar nga zotërinjtë Njazi Jaho e Kujtim Çashku.

2. MINISTRIA E DREJTËSISË, në mungesë.

3. KABINETI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, në mungesë.

4. KRYESIA E KUVENDIT POPULLOR, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 43 të ligjit nr.8175, datë 23.12.1996 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesin e Komitetit Shqiptar", të Helsinkit, si subjekt i interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

Mbi propozimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Gjykata Kushtetuese me nismën e saj, shqyrtoi pajtueshmërinë me normat kushtetuese të nenit 43 të ligjit nr.8175, datë 23.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7855, datë 27.1.1995 në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë".

Në paragrafin e parë të kësaj dispozite thuhet: "Për veprat penale të parashikuara nga ky ligj, organet që bëjnë ndalimin e autorëve të veprave penale brenda 48 orëve, duhet t'i kërkojnë prokurorit nxjerrjen e urdhërit për arrestimin e personave të ndaluar, i cili, menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, vendos arrestimin ose lirimin e tyre".

Përmbajtja e kësaj dispozite vjen në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993, ku thuhet se : "Askush nuk mund të mbahet i ndaluar më tepër se 48 orë".

Duke interpretuar këtë normë të ligjit kushtetues, Gjykata Kushtetuese del me konkluzionin se ky hark kohor fillon nga çasti i ndalimit dhe mbaron në çastin e vlerësimit të masës së sigurimit nga ana e Gjykatës, gjë që ka gjetur pasqyrim të plotë edhe në dispozitat e neneve 257, 258 e 259 pika 5 të Kodit të Procedurës Penale.

Mirëpo, në rast se do të zbatohet neni 43 i ligjit objekt shqyrtimi, del se ky afat i përcaktuar në ligjin kushtetues, nuk do të respektohet.

Akoma më e theksuar bëhet shkelja e këtij ligji kushtetues si rezultat i formulimit jo të saktë të dy paragrafeve të tjerë të nenit 43 të ligjit të ri.

Në paragrafin e dytë të kësaj dispozite thuhet : "Gjykata e shkallës së parë, pas kalimit të 5 ditëve nga nxjerrja e urdhërit të arrestimit, me kërkesën e prokurorit ose në bazë të ankimit të personit të arrestuar vlerëson urdhërin e arrestimit".

Siç del nga përmbajtja e kësaj pjese të ligjit, duhet të kalojnë edhe 5 ditë të tjera nga çasti i

nxjerrjes së urdhërit të arrestimit, që gjykata të bëjë vlerësimin e tij.

Sigurisht që një formulim i tillë është i pasaktë dhe kjo pasaktësi të çon në interpretime të gabuara sepse ngatërohet instituti i vlerësimit të arrestit me atë të revokimit ose zëvendësimit të kësaj mase sigurimi, të cilat siç dihet janë dy momente që ndryshojnë krejtësisht nga njëri-tjetri.

Tepër flagrante janë edhe shkeljet kushtetuese që vërehen në ndërtimin e paragrafit të fundit të nenit 43 të ligjit të sipërpërmendur.

Në këtë dispozitë është parashikuar se në rast se kundër vendimit të gjykatës për lirim të personit të arrestuar bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë nga ana e prokurorit, atëhere vendimi për lirim të menjëhershëm të personit të arrestuar pezullohet deri në marrjen e vendimit nga ana e gjykatës që shqyrton ankimin.

Është mëse e qartë se pezullimi i këtyre vendimeve gjyqësore përbën një nga shkeljet më flagrante të së drejtës së lirisë dhe të sigurisë, të parashikuar nga neni 5 i Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 dhe neni 5 i Konventës Europiane "Për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut".

Pas vendimit për lirim nga gjykata, personi nuk mund të mbahet në gjendjen e privimit të lirisë.

Një konkluzion i tillë del nga vetë përmbajtja e nenit 5 të ligjit kushtetues, i cili ka gjetur pasqyrim të plotë në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Madje, sipas këtyre dispozitave, personi i ndaluar ose i arrestuar duhet të lirohet menjëherë edhe në rastet kur gjykata nuk arrin të bëjë vlerësimin e këtyre masave brenda 48 orëve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 43 të ligjit nr.8175, datë 23.12.1996 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi pjesërisht kundër vendimit të shumicës dhe konkretisht për lënien në fuqi të paragrafit të parë dhe të tretë të nenit 43 dhe për shfuqizimin e paragrafit të dytë dhe të fundit për këto arsye :

1. Paragrafi i parë i atij neni nuk ka përmbajtje antikushtetuese derisa nuk e ka afatin e 48 orëve për arrestimin apo ndalimin dhe sepse nuk vjen në kundërshtim edhe me nenin 5 të ligjit për "Të drejtat dhe lirite themelore të njeriut", dhe as me ndonjë Konventë Ndërkombëtare;

2. Paragrafi i tretë që përmban se : "Gjykata në vlerësimin e urdhërit të arrestimit zbaton në përputhje me këtë rregun, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, që përcaktojnë rregullat procedurale për gjykimin e vlerësimit të arrestimit ose të ndalimit", nuk bën gjithashtu asnjë shkelje dhe është një provë tjetër e shkeljeve të paragrafit të dytë.

Tiranë, më 5.12.1997

ANËTAR
H. Dakli

ANËTARI
M. Konomi